

Vendim nr. 9 datë 20.01.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 20.01.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 30 (A) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARBEN DEMNERI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-1639, datë 07.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 102, datë 03.07.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 71, 71/1 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi rezulton se është trashëgimtar ligjor i të ndjerëve Q.D., SH.D. dhe H.D., të cilëve Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave (KKKP) i Bashkisë, Tiranë, me vendimin nr. 708, datë 12.09.1996, u ka njohur të drejtën e pronësisë për dy ndërtesa,

përkatësisht 2 dhe 3 kate, pronë që sot përbëhet nga një truall me sipërfaqe prej 296 m², nën Muzeun Historik Kombëtar. Për këtë sipërfaqe, KKKP-ja ka disponuar me vendimin përkatës që të kompensohen ish-pronarët në një nga format e ligjit, vendim që ka mbetur i paekzekutuar.

2. Në datën 24.02.2016 ka hyrë në fuqi ligji nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 133/2015*). Në bazë e për zbatim të këtij ligji ka dalë vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 23.03.2016 “Për caktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (*VKM-ja nr. 223/2016*). Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 133/2015 dhe VKM-së nr. 223/2016, Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) ka urdhëruar publikimin në Buletinin Zyrtar të Regjistrit të Vlerësimit për vendimet përfundimtare që janë shprehur për njohjen e së drejtës së kompensimit për vitin 1996.

3. Sipas vlerësimit të bërë nga ATP-ja rezulton se në listën e publikuar në kolonën “Vlerësimi” në favor të trashëgimlënësve të kërkuarit është vënë shuma 19.822.824 lekë. Në këto kushte, kërkuari, duke mos qenë dakord me këtë shumë, në referim të kriterëve të nenit 19 të ligjit nr. 133/2015, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadi me objekt kundërshtimin e vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 102, datë 03.07.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuarit si të pabazuar në ligj e prova. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuari.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1639, datë 07.07.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit për themelin e çështjes, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

6. Gjithashtu, kërkuari, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC), në datën 27.05.2022, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 23/2022, datë 19.07.2022, me arsyetimin se mosveprimi i Gjykatës së Lartë në gjykimin e çështjes së kërkuarit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, si dhe duke pasur parasysh faktin se çështja e themelit është gjykuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vlerësuar se kërkesa për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka mbetur pa objekt dhe, për këto arsye, ka vendosur pushimin e gjykimit.

8. Në datën 15.11.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 02.12.2022, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1639, datë 07.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe konstatimin e cenimit të procesit të rregullt, si pasojë e mosgjyqimit të çështjes brenda një afati të caktuar.

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkuesi**, në kërkesën drejtuar Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se janë cenuar:

9.1. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka kryer një hetim të plotë. Kjo gjykatë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuetit për cenimin e së drejtës së pronës. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, nuk ka kryer një vlerësim ligjor ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykatat nuk kanë dhënë përgjigje se përse zbatohet VKM-ja nr. 89/2016 dhe jo VKM-të e tjera që kanë qenë në fuqi gjatë gjithë këtij procesi, pra ajo më e favorshme për kërkuetin. Në rastin konkret, gjykatat e kanë trajtuar çështjen në kundërshtim të përcaktimeve të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 133/2015, ndërkohë që nuk kanë arsyetuar në lidhje me vlerën që do të zbatohet në rastin e kërkuetit.

9.2. *Parimi i barazisë së armëve*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka pranuar kërkesën e kërkuetit për të thirrur ekspert për të bërë vlerësimin e pronës sipas vlerës që i korrespondon statusit të saj.

9.3. *E drejta e pronës*, pasi gjykatat nuk kanë respektuar standardin kushtetues të shpërblimit të drejtë. Gjykata Administrative e Apelit, duke u kufizuar vetëm në parashikimet e neneve 6 dhe 7 të ligjit nr. 133/2015, por edhe në përcaktimet e bëra në VKM-në nr.223/2016, nuk ka vlerësuar dhe interpretuar që gjendja e faktit përfaqëson cenimin e një vlerësimi dhe kompensimi të drejtë të pronës. Kërkesa për kompensim financiar është kërkuar edhe kur në fuqi kanë qenë akte nënligjore më të favorshme për kërkuetin, të cilat parashikonin një kompensim financiar më të lartë për pronën e kompensuar, por ATP-ja nuk ka vepruar, duke mos i dhënë kështu një shpërblim të drejtë. Llogaritja e vlerësimit financiar nuk është bërë sipas një metodologjie transparente dhe nuk është nisur nga statusi i

pronës në momentin e shpronësimit.

9.4. *Shqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm.* Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 21.09.2018, ndërkohë që vendimi për të është dhënë në datën 07.07.2022. Pra, për një periudhë prej më shumë se 4 vjetësh, në kundërshtim me nenin 60 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit. Në datën 27.05.2022, kërkuesi ka bërë kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 23/2022, datë 19.07.2022, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës, pasi rekursi ishte shqyrtuar në datën 07.07.2022.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive

për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1639, datë 07.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nuk ka mjet tjetër për të shteruar. Gjithashtu, edhe për kërkesën për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt, si pasojë e mosgjyqimit të çështjes brenda një afati të caktuar, kërkuesi nuk ka mjet tjetër për të shteruar. Për këtë arsye, ai e plotëson edhe këtë kriter.

14. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 15.11.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), ndërsa vendimet gjyqësore që kundërshtohen prej tij, janë dhënë nga Gjykata e Lartë, përkatësisht në datat 07.07.2022 dhe 19.07.2022 (për kërkesën për tejkalim afati të arsyeshëm). Gjithashtu, me anë të shkresës nr. 6131/1 prot., datë 22.11.2022 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, të paraqitur nga kërkuesi, është provuar se vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-1639, datë 07.07.2022, që kundërshtohet nga kërkuesi, është bërë i aksesueshëm për t’u tërhequr nga palët në datën 01.08.2022 dhe nga ky moment fillon të llogaritet afati 4-mujor. Për pasojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, sipas jurisprudencës kushtetuese kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së pronës, pasi gjykatat nuk kanë respektuar standardin kushtetues të shpërblimit të drejtë. Sipas tij, Gjykata Administrative e Apelit, duke u kufizuar vetëm në parashikimet e neneve 6 dhe 7 të ligjit nr. 133/2015, por edhe në përcaktimet e bëra në VKM-në nr. 223/2016, nuk ka marrë në vlerësim dhe interpretim që gjendja e faktit përfaqëson cenimin e një vlerësimi dhe

kompensimi të drejtë të pronës. Kërkesa për kompensim financiar është kërkuar edhe kur në fuqi kanë qenë akte nënligjore më të favorshme për kërkuesin, të cilat parashikonin një kompensim financiar më të lartë për pronën e kompensuar, por ATP-ja nuk ka vepruar, duke mos i dhënë kështu një shpërblim të drejtë. Llogaritja e vlerësimit financiar nuk është bërë sipas një metodologjie transparente dhe nuk është nisur nga statusi i pronës në momentin e shpronësimit.

17. Në kuptim të sa më sipër, për sa u përket argumenteve të kërkuesit për cenimin e së drejtës së pronës, Kolegji konstaton se ai ka sjellë argumente të përgjithshme me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese që, në thelb, kanë të bëjnë tërësisht me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, të cilat, për nga natyra, nuk hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kërkuesi nuk ka arritur të evidentojë konkretisht të drejtën që i është cenuar atij nga procesi i zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Gjithashtu, kërkuesi, ndër të tjera, kërkon konstatimin e cenimit të procesit të rregullt, si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

19. Në lidhje me këtë pretendim të tij, Kolegji konstaton se për çështjen e themelit të kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1639, datë 07.07.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit. Përpara dhënies së këtij vendimi, në datën 27.05.2022, kërkuesi ka paraqitur kërkesë po në këtë gjykatë me objekt konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për çështjen e tij të themelit. Në shqyrtimin e kësaj kërkesë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 23/2022, datë 19.07.2022, pasi ka analizuar dhe arsyetuar mbi pretendimet e kërkuesit për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, ka theksuar faktin se vonesa në shqyrtimin e çështjes konkrete ka ardhur për arsye objektive. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përfundim të gjykimit, pasi ka konstatuar se çështja e themelit është marrë në shqyrtim në nga Kolegji Administrativ, si dhe duke qenë se shqyrtimi i kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe kërkesa për përshpejtimin kishin mbetur pa objekt, bazuar në nenin 399/7, pika 3, të KPC-së, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës.

20. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, përderisa çështja e themelit është gjykuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke u vendosur mospranimi i rekursit, nuk arrihet të provohet më interesi i drejtpërdrejtë i tij për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt nga tejzgjatja e afateve të gjykimit të çështjes për kundërshtimin e vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja. Kërkuesi nuk ka arritur të paraqesë argumente të mjaftueshme kushtetuese për të provuar interesin që ka sjellë për të tejzgjatja e afateve të gjykimit të çështjes

dhe si ai është cenuar konkretisht në të drejtën e tij për proces të rregullt. Për më tepër, Kolegji vëren se çështja nuk është e një natyre të tillë që interesi i kërkuarit të rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurës gjyqësore të shqyrtimit të çështjes së tij. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuarit, që kanë të bëjnë me cenimin e standardit të arsyetimit dhe parimin e barazisë së armëve nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se ato *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës dhe do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuari pretendon se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka kryer një hetim të plotë. Ajo gjykatë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuarit për cenimin e së drejtës së pronës. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, nuk ka kryer një vlerësim ligjor ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas tij, gjykatat nuk kanë dhënë përgjigje se përse zbatohet VKM-ja nr. 89/2016 dhe jo VKM-të e tjera që kanë qenë në fuqi gjatë gjithë këtij procesi, pra ajo më e favorshmeja për kërkuarin. Në rastin konkret, gjykatat e kanë trajtuar çështjen në kundërshtim të përcaktimeve të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 133/2015, ndërkohë që nuk kanë arsyetuar në lidhje me vlerën që do të zbatohet në rastin e kërkuarit.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si garanci për procesin ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre.

Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 16 datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar, i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, është tregues i faktit se kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se vendimet e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, plotësojnë kriteret e vendosura më sipër nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Ato përmbajnë të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta (në rastin e vendimit të Gjykatës së Lartë), shkaqet e ngritura në ankim/rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ato mbështesin qëndrimin e tyre të shprehur në dispozitiv. Ato nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë. Gjithashtu, Kolegji vëren se Gjykata e Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në ankim/rekurs nga kërkuesi, duke u dhënë përgjigje në thelb atyre. Për sa i përket arsyetimit të kufizuar që përdor Gjykata e Lartë, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se ai nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

26. Kërkuesi pretendon se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka pranuar kërkesën e tij për të thirrur ekspert për të bërë vlerësimin e pronës sipas vlerës që i korrespondon statusit të saj.

27. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces,

si dhe mundësia e deklaramit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr.21, datë 20.03.2017; nr.28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në jurisprudencë të vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr.9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr.19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme në çështjen konkrete, Kolegji vëren se nuk rezulton që kërkuesi të jetë vënë në pozita të pabarabarta me palën e paditur. Atij i është dhënë mundësia, gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit, që të kundërshtojë vlerësimin financiar të kryer nga ATP-ja, të debatojë në lidhje me të, si dhe të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tij. Gjithashtu, ky pretendim i kërkuetit është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila me anë të vendimit të saj është shprehur se: “[...] përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit material dhe procedural. Gjithashtu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se “gjykata ka zhvilluar një hetim të gjithanshëm të çështjes dhe konkluzioni i saj është rrjedhojë e një analize tërësore dhe objektive të provave””. Për këto arsye, edhe ky pretendim i kërkuetit është i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.